

PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË CIKLIT FILLOR

1.METODA “KUBIMI”

Në orën mësimore të lëndës abetare, klasa e parë, me temë mësimore: përsëritje 2 (grupi i 2 i shkronjave), u përdor metoda e kubimit, e parashikuar në planin e orës mësimore, e cila më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Tregova para nxënësve etiketat me të 4 modelet e secilës shkronjë të mësuar dhe nxënësi i emërtoi ato. Rikujtuam shkronjat e të dyja grupeve të mësuara. *N e madhe e shtypit, o e vogël e shtypit, K e madhe e dorës, l e vogël e dorës...*
- Ndava klasën në 6 grupe dhe për secilin grup përdora metodën e kubimit, ku kisha ndërtuar një kub dhe në faqet e tij kisha shënuar 6 shkronjat e mësuara të alfabetit. Me hedhjen e kubit e me shkronjën që i ra nxënësit shkruajtën sa më shumë fjalë me shkronjën e dhënë në pozicionet të ndryshme të kësaj shkronje.
- Më pas secili grup lexoi fjalët e gjetura dhe grupi që kishte gjetur më shumë fjalë u shpall fitues.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e kubimit sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuese: Adela Bonjaku

adela.bonjaku@gea.edu.al

2.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës Abetare, klasa 1 B, me temë mësimore Shkronja P, p dhe me koncept kryesor marrja e shkronjës/tingullit të ri në alfabetin tonë u përdor metoda e punës në grupe, që e kisha parashikuar në planin e orës mësimore. Ajo më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Puna në grupe u zbatua në këtë mënyrë.

- Organizova klasën në 6 grupe me nga 4 veta dhe për secilin grup ndava detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij, si dhe secilin grup e kisha pajisur me fletë të mëdha me ngjyra sipas grupeve dhe mjete shkrimi.
- Secili grup punoi për detyrën e përcaktuar, ku anëtarët do të gjenin/ thonin fjalë që përmbajnë shkronjën P, p ndërsa kryetari do të shkruante. Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili/a nxënës/e, ndërkohë kam monitoruar klasën dhe kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 5 minuta.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup, u vu re që fjalët e gjetura e përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënësit që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuese: Dorjana Aliaj

dorjana.aliaj@gea.edu.al

3. METODA "PUNË NË DYSHE".

Në orën mësimore të lëndës Abetare, klasa 1-D, me temë mësimore "Vendvlerat e numrave" dhe me koncept kryesor ndarjen e numrit në dhjetëshe dhe njëshe, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Organizova klasën në dyshe, ku secili nxënës kishte një etiketë, shufra dhe kube para. Secili nxënës shkruajti një numër dyshifror dhe ia kaloi shokut/shoqes së bankës.
- Pasi panë numrin nxorën aq shufra dhe aq kube sa tregon numri. U angazhua secili nxënës, por edhe unë si mësuese i kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar në veprimtarinë e tyre, e cila zgjati 10 minuta.

Pas prezantimit të punës së bërë nga secili nxënës vura re se rezultatet e të nxënësve ishin arritur me sukses nga të gjithë nxënësit.

Mësuesja: Entela Hidaj

entela.hidaj@gea.edu.al

4. METODA "KONKURS ME KAHOOT"

Në orën mësimore të lëndës matematikë, klasa e parë C, me temë mësimore: "Një më shumë, një më pak" dhe me koncept kryesor numrin, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në fazën e tretë të orës mësimore, në këtë mënyrë:

- Nxënësit punuan me 4 grupe me nga 6 nxënës në çdo grup. Me Kahoot të krijuar nga unë u mundova të përforcojmë njohuritë e mara në lidhje me relacionin një më shumë, një më pak në formën e një konkursi.
- Secili pjesëtar i grupit u përgjigj në një pyetje e më pas të gjithë së bashku për pyetje më bashkëpunuese.
- Fitoi grupi i cili u përgjigj më saktë por edhe më shpejtë.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës me konkurs e sidomos duke përdorur Kahoot.

Metoda e Kahoot është efektive në mësimdhënien për shkak të veprimtarive të nxënësve përmes lojërave ndërvepruese, sepse ajo rrit motivimin dhe përfshirjen e tyre në procesin e të nxënësve. Për më tepër, mësuesit mund të mbledhin në një kohë reale të dhëna për progresin e nxënësve, si dhe jep mundësi për të identifikuar zonat që janë më shumë përqendrim. Përdorimi i kësaj metode krijon një mjedis më të gjallë dhe gjithëpërfshirës në klasë, sepse nxitet bashkëpunimi dhe konkurrenca pozitive.

Mësuesja: Egesa Duka

egesa.duka@gea.edu.al

5. METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa 2-A me temë mësimore “Teksti”, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Ndava klasën në 4 grupe me nga 6 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij. Secili grup u pajis me etiketa fjalësh dhe fjalish me ngjyra, tabakë të bardhë dhe ngjitës letre. Detyra e grupeve ishte që me etiketat me ngjyrë të njëjtë të ndërtonin fjali dhe fjalitë t’i renditin sipas kuptimit për të ndërtuar një tekst.
- Secili prej grupeve punuan të pavarur, duke u angazhuar secili nxënës, por dhe unë e kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 2 minuta, u vu re që produktet e tyre ishin mbresëlënëse dhe përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënit që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore (rendit sipas kuptimit fjalitë, për të formuar një tekst). U përgëzuan dhe u duartrokitën nxënësit për punën në grup.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Flora Osmanaj

f.osmanaj@gea.edu.al

6. METODA “RRJETË MERIMANGE”

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa 2-B me temë mësimore “Pyesim dhe përgjigjemi”, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Ndava klasën në 3 grupe me nga 7 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij. Secili grup u pajis me një lëmsh me ngjyra të ndryshme. Detyra e grupeve ishte që secili nxënës të bënte një pyetje dhe ta hidhte lëmshin tek shoku që kishte përballë. Nxënësi/ja që pret lëmshin i përgjigjet pyetjes dhe i bën pyetje shokut/shoqes tjetër. Kështu veprojnë të gjithë grupet. Kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 2 minuta, u vu re që produktet e tyre ishin mbresëlënëse dhe përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënit që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore .

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh këtë metodë, sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Irsida Seitaj

i.seitaj@gea.edu.al

7.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës Gjuha Shqipe, klasa 2-C, me temë mësimore “Dallojmë emrin”, metoda e punës në grupe, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Organizova klasën në 4 grupe me nga 6 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij, si dhe secili grup u pajis me fletë A4 dhe stilolapsa. Grupet punuan për dallimin e emrit si fjalë që tregojnë njerëz, kafshë, sende ose vende dhe krijimin e fjalive duke përdorur emrin e përgjithshëm e duke treguar çfarë tregojnë.
- Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili nxënës, por dhe në grup duke diskutuar me njëri-tjetrin për paqartësitë. Unë si mësuese kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 5 minuta, u vu re që nxënësit kishin krijuar fjali të larmishme dhe kishin përdorur saktë emrat e përgjithshëm sipas caktimit në grup. Nxënësit përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënës që ishte vendosur për atë orë mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe sepse ajo krijon një ndërveprim, përfshirje të lartë në të nxënë si dhe i mundëson nxënësve të bashkëpunojnë me njëri -tjetrin. Është metodë efektive për të “përballuar” një nga sfidat e këtij shekulli, atë të komunikimit dhe ndarjes së ideve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo virtuale.

Mësuesja: Dorina Haxhiu

dorinahoxhahaxhiu@gmail.com

8. METODA “PEMA E MENDIMEVE”

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa III -A me temë mësimore ‘Levizja e fjalëve në fjali’ dhe me koncept kryesor ‘Zhvendosjen me kuptim të fjalëve në fjali’, parashikova në planin e orës mësimore teknikën ‘Pema e mendimeve’ dhe si veprimtari punën në grupe. Kjo teknikë më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Teknika dhe veprimtaria u zbatua në këtë mënyrë:

- Organizova klasën në 4 grupe me nga 6 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij, si dhe secili grup u pajis me etiketa të bardha, lapustila dhe ngjitës. Në tabelë u paraqit një fjalë ‘Fjalja’
- Nxënësit punuan të pavarur, duke u angazhuar në bashkëpunim për të mos përsëritur informacionin dhe për të gjetur informacione që rrjedhin nga njëri – tjetri, në formën e degëve të pemës. Monitorova gjatë kohës së punës grupet duke i udhëzuar. Puna zgjati 10 minuta.
- Çdo grup prezantoi me nga 2 minuta produktin, i cili përmbushte arritjen e rezultatit të të nxënës për këtë orë mësimi.

U vijua me ndërtimin e një fjalie duke zhvendosur fjalët e dhëna nga unë, fjalë këto të njëjta për secilin grup. Punët e paraqitura para klase prezantuan te nxënësit se fjalja ka kuptim edhe po ndryshoi vendndodhja e fjalëve.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh veprimtarinë e punës në grupe dhe metodën e “Pemës së mendimeve”, sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë dhe përfshin bashkëveprimin dhe mundëson atmosferë pozitive.

Mësuesja: Klodjana Hoxha

k.hoxha@gea.edu.al

9. TEKNIKA “RRJETA E MERIMANGËS”

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa III -B, me temë mësimore “Emri” dhe me koncept kryesor dallimin e emrit dhe veçorive të tij, u parashikua në planifikimin e orës mësimore përdorimi i teknikës “Rrjeta e merimanges” në lojë me fjalë . Kjo teknikë më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen për realizimin e rezultateve të të nxënit.

Teknika dhe veprimtaria u zbatua në këtë mënyrë:

- Organizova klasën në rreth dhe udhëzova nxënësit për t’u përfshirë në një aktivitet në formë loje, për të sjellë sa më shumë njohuri për emrin.
- Mjeti i përdorur për realizimin e teknikës ishte një top.
- Nxënësit bashkëvepruan në zinxhir për të dhënë në një linjë logjike informacionet e mësuarat për emrin (nga klasa e dytë).
- Monitorova gjatë kohës së punës grupin duke i udhëhequr dhe duke i udhëzuar. Puna zgjati 10 minuta.
- Në fund realizova një përmbledhje, përmes një skeme në tabelë.
- Nxënësit sollën edhe shembuj përbri informacioneve, duke treguar përvetësim të qëndrueshëm të njohurive për emrin.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh veprimtarinë e lojës dhe metodën e “Rrjetës së merimangës” sepse mban gjallë interesin e fëmijëve dhe siguron mbajtjen mend të njohurive. Gjithashtu ndërveprimi është i efektshëm.

Mësuesja: Lindita Mitrovica

lindita.mitrovica@gea.edu.al

10. TEKNIKA “PUNË NË DYSHE”

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa III -C, me temë mësimore “Fjalja pohore dhe mohore” me koncept kryesor ‘Përdorimi i fjalive mohuese’ parashikova në planin e orës mësimore teknikën e punës në grupe dyshe. Kjo teknikë më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë.

Teknika u zbatua në këtë mënyrë:

- Organizova klasën në grupe me nga 2 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat .Në tabelë u paraqit një shembull i një fjalie pohore dhe mënyrat e kthimit të saj në mohore.
- Nxënësit punuan në grupe të vogla, duke u angazhuar për të gjetur formën e duhur mohore ose pohore të shembullit që iu dha atyre. U theksuan rastet kur nuk përdoret fjalëza mohuese ‘s’.
- Monitorova gjatë kohës së punës grupet duke i udhëzuar. Puna zgjati gati 10 minuta.

Veprimtaria siguroi përmbushjen dhe arritjen e rezultatit të të nxënës që ishte vendosur për atë koncept të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh veprimtarinë e punës në grupe dyshe, sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë, një përqendrim më të madh për të përvijuar mendimin e paraardhësit.

Mësuesja: Sidiola Laze

sidiola.laze@gea.edu.al

11. TEKNIKA “PËRVIJIMI I TË MENDUARIT”

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa IV -A, me temë mësimore ‘Përforsim njohurish-emri’ dhe me koncept kryesor “Klasifikoni emrat sipas trajtës dhe numrit “, parashikova në planin e orës mësimore teknikën ‘Përvijimi i të menduarit’. Kjo teknikë më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Teknika u zbatua në këtë mënyrë:

- Përgatita disa etiketa me emra të llojeve të ndryshme në gjininë femërore dhe mashkullore , në trajtën e shquar dhe të pashquar, në numrin njëjës dhe shumës.
- Udhëzova nxënësit që të tërheqë secili nga një fishë, të cilat janë vendosur mbi tavolinë dhe t’i vendosin në tabelën e paraqitur në smart-bord ku do të indentifikonin trajtën dhe numrin e emrit të dhënë. Kjo veprimtari zgjati 10 minuta.
- Në fund të veprimtarisë, diskutuam së bashku saktësinë e punëve të nxënësve dhe vlerësimin e tyre me shprehje motivuese.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin metodën “Përvijimi i të menduarit” sepse është një metodë shumë efektive që i ndihmon nxënësit të analizojnë dhe të kuptojnë konceptet. Kjo teknikë nxit mendimin kritik dhe analitik, i ndihmon nxënësit të analizojnë informacionin dhe të zhvillojnë aftësi për të menduar në mënyrë më të thelluar dhe të strukturuar .

Mësuesja: Eva Raka

e.raka@gea.edu.al

12.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës: Gjuhë shqipe, klasa IV – B, me temë mësimore “22 Nëntori-Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe” dhe me koncept kryesor mbi rëndësinë që ka Kongresi i Manastirit në krijimin e alfabetit të gjuhës shqipe, nxënësit përpunuan informacionin e marrë të ndarë në grupe të ndryshme dhe prezantuan punën e përgatitur nga secili grup.

Metoda e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Organizova klasën në 4 grupe me nga 6 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij, si dhe secili grup u pajis me fletë të mëdha të bardha, shënjes me ngjyra/markers dhe ngjitës letre.
- Secili grup punoi për detyrën **G. 1- Informacione mbi Kongresin e Manastirit mbi anëtarët pjesëmarrës. G. 2-Rëndësinë e asaj dite dhe vendin ku u zhvillua. G. 3 - Anëtarët më të rëndësishëm të asaj dite dhe informacion rreth tyre. G. 4 Foto nga vendi dhe 36 shkronjat e Alfabetit.**
- Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili/a nxënës/e, por dhe unë si mësuese i kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup me nga 5 minuta, u vu re që produktet e tyre ishin mbresëlënëse dhe përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënës që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Etleva Merko

etleva.merko@gea.edu.al

13. TEKNIKA “STUHI MENDIMESH”

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa 5-A, me temë mësimore: “Lindja e Gjergj Kastriotit” dhe me koncept kryesor “të lexuarit” për të mësuar e kuptuar duke zhvilluar aftësitë folëse e shprehëse, teknika e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Teknika u zbatua në këtë mënyrë.

- Organizova klasën për të parë një fragment nga filmi shqiptar “Skënderbeu” dhe më pas i orinetova nxënësit drejt dëgjimit të pyetjeve të mbyllura dhe të hapura me anë të “stuhisë së mendimeve” në mënyrë që ata të flisnin dhe të jepnin informacione dhe argumente.
- Secili nxënës u përfshi në diskutim, shprehu mendimin e tij dhe solli në formën e kurioziteteve dhe informacioneve historike, vjershave dhe krijimeve popullore dhe artistike figurën e Gjergj Kastriotin.
- Gjatë prezantimit u vu re se secili nxënës diskutoi dhe paraqiti idetë e tij, gjë që dëshmoi arritjen e rezultatit të të nxënës, që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh teknikën “Stuhive mendimesh” sepse krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë. Gjatë punës me këtë teknikë nxënësit janë në gjendje të mendojnë dhe të shprehin më lirshëm, sugjerojnë shumë ide të reja, nxjerrin konstatime e ide që nga faza e parashikimit deri në atë të përfundimit.

Mësuesja: Nevila Fero

nevila.fero@gea.edu.al

14.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa 4-C, me temë mësimore ‘Emri i shquar dhe i pashquar’ (ora e dytë) dhe me koncept kryesor “Emri”, metoda ‘punë në grupe’, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë.Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Organizova klasën në 6 grupe me nga 4 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij (me anë të një kubi në mënyrë rastësore u ndanë konceptet kryesore të emrit), si dhe grupet u pajisën me fletë me ngjyra dhe markers.
- Secili grup punoi për detyrën për “Emrin”. Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili/a nxënës/e, por dhe unë si mësuese kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin grup në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës së secilit grup , u vu re që njohuritë e tyre përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënit që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Deshira Lashi

deshira.lashi@gea.edu.al